



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 600/14 Prot.

Tiranë, më 03. 12 . 2024

V E N D I M
Nr. 296, datë 03 .12. 2024

Mbështetur në ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi shqyrtoi ankesën me nr. 85 Regj., datë 18.04.2024, paraqitur nga pala ankuese znj. V.K , kundër Shoqërisë ELALBA – 1 sh.p.k, me Nipt K12202003J, përfaqësuar nga administratori z. N. D, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesja znj.K. , parashtron se, është person me aftësi të kufizuara në shikim dhe përfiton nga statusi i të verbërit, grupi i dytë. Znj. K. informon se, në datën 14.04.2024 ka hipur në Tiranë në autobuzin me targa AB 347 ED, të linjës Tiranë – Durrës për të shkuar në Durrës, në orarin 2 të drekës. Kur fatorino i është drejtuar për të kryer pagesën e biletës, znj.K. i ka dhënë gjysmën e çmimit të biletës, sipas parashikimeve të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar duke i treguar edhe librezën e verbërisë, por fatorino i ka thënë e ke fallco.

Ankuesja deklaron se, pavarësisht se ishte e pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me statusin e saj si person me aftësi të kufizuara, dokumentacion të cilin ia ka paraqitur fatorinos, ky i fundit nuk donte t’ia dinte në lidhje me këtë të drejtë, si dhe e ka e ofenduar. Znj. K. , informon se, fatorino ka vazhduar që ta ofendojë gjatë gjithë udhëtimit, por edhe pasi ajo ka zbritur

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

nga autobuzi. Znj.K. pretendon se në këtë linjë ky faktorino ka patur të njëjtën sjellje ndaj saj edhe në raste të tjera.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të shprehur shkakun e diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, atë të aftësisë së kufizuar. Në nenin 1, të LMD përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi ose mosveprimi* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë ose privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfiturar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

.....

f) lehtësi për transport ose udhëtim; ”

1. Në kushtet kur, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Tiranë - Durrës, me të cilën kishin udhëtuar në datën 14.04.2024, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese, Komisioneri nëpërmjet shkresës nr. 600/1 prot, datë 30.04.2024, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim.

1.1 Me shkresën nr.9086/1 prot, datë 08.05.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se: *“Nga verifikimi në sistemin elektronik e-Transport, rezulton se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Durrës-Tiranë, është licencuar shoqëria “ELALBA – 1” sh.p.k, me NIPT K12202003J, mbajtës i licencës me nr.9, lëshuar në datë 12.05.2022, me afat vlefshmërie deri në datë 11.05.2027. Për sa i përket kërkesës për informacion për mjetin me targë AB 347 ED, rezulton në pronësi të subjektit “ELALBA 1” sh.p.k dhe është i pajisur me certifikatë operimi nr.23, lëshuar në datë 09.11.2023, me afat vlefshmërie deri në datë 09.11.2024 në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Tiranë-Durrës-Tiranë.”*

Pasi ankesa u plotësua me informacionin e nevojshëm në lidhje me identifikimin e subjektit, në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenin 33 të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar Komisioneri ndërmori hapat si më poshtë:

2. Me shkresën me nr. 600/3 prot., datë 13.05.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria ELALBA-1 sh.p.k, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

2.2 Me shkresën nr.01/5 prot, datë 24.05.2024³, Shoqëria ELALBA - 1 sh.p.k ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën. Në parashtrimet e sjella shoqëria parashtron:

Shoqëria ELALBA 1 sh.p.k zhvillon aktivitete nga viti 2001 në sektorin jo publik të transportit të udhëtarëve. Lidhur me ngjarjen e datës 14.04.2024 që pretendon znj.V.K , fatorino E.Q nuk i pranon. Ai thotë se i ka marrë ½ e vlerës së biletës. Nuk ka përdorur fjalë fyese, por ka folur me zë të lartë. Megjithatë në mënyrë të vazhdueshme ne si shoqëri ju bëjmë të qartë drejtuesve të mjeteve dhe fatorinove që të zbatojnë kërkesat e ligjit 8098/96, 8153/96 të ndryshuar, 26/2012 për statusin e të verbërve të cilët udhëtojnë me 50% të vlerës së biletës.

3. Nëpërmjet shkresës nr.600/6 prot datë 29.05.2024, ankueses i është komunikuar përgjigja e shoqërisë. Ankuesja nuk depozitoi parashtrime shtesë.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”* dhe

³ Administruar pranë Komisionerit me nr. 600/4 prot., datë 27.05.2024.

për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore në datën 21.10.2024 ora 10:00.

Në seancë dëgjimore mori pjesë ankuesja znj.V.K dhe përfaqësuesi i saj (me deklaram gjatë seancës dëgjimore) z. S.F, President i Shoqatës “Shpresë për të verbërit”, Shoqëria ELALBA – 1 sh.p.k, përfaqësuar nga Administratori z. N. D dhe z. E. Q, fatorino pranë kësaj shoqërie.

Gjatë seancës dëgjimore pala ankuese i qëndroi pretendimeve për diskriminim që ka parashtruar në ankesë, ndërsa Shoqëria ELALBA – 1 sh.p.k, përfaqësuar nga Administratori z. N.D dhe z. E.Q , fatorino pranë kësaj shoqërie prapësuan pretendimet e palës ankuese si të pabazuara.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Ankuesja V.K , është e datëlindjes 23.03.1951. Në bazë të dokumentacionit të administruar ajo është person me aftësi të kufizuar në shikim, Grupi II (dytë) dhe është përfituese e ligjit Nr.8098, datë 28.3.1996 “*Për Statusin e të Verbërit*”, i ndryshuar, me afat vlefshmërie përgjithmonë.

Ankuesja pretendon se, në datën 14.04.2024 ka hipur në Tiranë në autobuzin me targa AB 347 ED, të linjës Tiranë – Durrës, për të shkuar në Durrës, në orarin 2 të drekës. Kur fatorino i është drejtuar për të kryer pagesën e biletës, ankuesja deklaroi se i ka dhënë gjysmën e çmimit të biletës, sipas parashikimeve të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “*Për statusin e invalidit*”, i ndryshuar.

Ankuesja pretendon se, pavarësisht se ishte e pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me statusin e saj si person me aftësi të kufizuara, dokumentacion të cilin ia ka paraqitur fatorinos, ky i fundit nuk donte t’ia dinte në lidhje me këtë të drejtë dhe e ka ofenduar gjatë gjithë udhëtimit, por edhe pasi ajo ka zbritur nga autobuzi. Znj.K. pretendon se në këtë linjë ky fatorino ka patur të njëjtën sjellje ndaj saj edhe në raste të tjera.

Rezultoi e provuar gjatë shqyrtimit të ankesës se, linja e transportit në të cilën ka udhëtuar ankuesja është një linjë e transportit ndërqytetës që lidh qytetin e Tiranës dhe të Durrësit. Në bazë të informacionit të administruar rezultoi se, autobuzi me targa AB 347 ED, me të cilin ankuesja ka udhëtuar, është i pajisur me certifikatë operimi nr. 23, lëshuar në datë 09.11.2023, me afat vlefshmërie deri në datë 09.11.2024 në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Tiranë-Durrës-Tiranë, mjet i çertifikuar për operim nga Shoqëria ELALBA – 1 sh.p.k, me NIPT K12202003J.

Shoqëria ELALBA – 1 sh.p.k, ofron shërbimin e transportit në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Durrës-Tiranë bazuar në licensën me nr.9, lëshuar në datë 12.05.2022, nga DPSHTRR, me afat vlefshmërie deri në datë 11.05.2027.

Shoqëria ELALBA – 1 sh.p.k dhe z. E.Q , gjatë shqyrtimit të ankesës deklaruar se ankueses i është mbajtur gjysma e çmimit të biletës, pavarësisht se sipas tyre ankuesja nuk kishte treguar dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit, pasi ishte fotokopje dhe nuk ishte i lexueshëm, dhe se në asnjë moment përgjatë udhëtimit ndaj saj nuk janë përdorur fjalë ofenduese apo fyese.

Bazuar në deklaratimet e bëra nga pala ankuese gjatë seancës dëgjimore, ajo pranoi se ka paguar gjysmën e çmimit të biletës. Në lidhje me dokumentacionin që ajo ka paraqitur për të përfituar nga lehtësirat e ofruara nga ligji në lidhje me çmimin e biletës së udhëtimit, ankuesja deklaroi se ajo kishte me vete të gjithë dokumentacionin, Librezën e Verbërisë të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, Librezën e Verbërisë të lëshuar nga Shoqata “*Shpresë për të Verbërit*” si dhe Vendimin e Komisionit që ka caktuar verbërinë, duke theksuar se i ka paraqitur faktorinos librezën origjinale të lëshuar nga Shoqata Shpresë për të Verbërit.

Për sa i përket fjalëve fyese dhe ofenduese që ankuesja pretendon se janë përdorur ndaj saj nga ana e faktorinos, ajo deklaroi gjatë seancës dëgjimore se kishte kaluar një kohë e gjatë dhe nuk i mbante mend, por që ishte ndjerë e fyer dhe ofenduar gjatë gjithë udhëtimit dhe kjo ishte që situatë e përsëritur.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur rezultoi e provuar, pasi pranohet nga të dy palët, se ankuesja ka paguar gjysmën e çmimit të biletës, nuk është e nevojshme që të ndalet dhe të analizojë në lidhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të drejtën për të përfituar lehtësira në transport për personat me aftësi të kufizuara në shikim. Megjithatë, Komisioneri çmon që të ndalet vetëm për sa i përket mënyrës se si përfitohen lehtësirat e parashikuara nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi.

Në mënyrë të vazhdueshme në praktikën e tij, Komisioneri ka vlerësuar se, ligji ua njeh të drejtat të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform *detyrimit* për të paraqitur në çdo rast udhëtimi *dokumentin ligjor specifik*. Komisioneri ka vlerësuar se, personat me aftësi të kufizuara në shikim kanë detyrimin për të paraqitur dokumentin origjinal ose fotokopjen e noterizuar të Librezës së Verbërie të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), si dokumenti i vlefshëm sipas përcaktimeve specifike ligjore, në mënyrë që të përfitojnë nga lehtësirat përcaktëse për të udhëtuar në transportin urban ndërqytetas. Ndërsa, autoriteti përgjegjës dhe zyrtar për paisjen e personave të verbër me dëshminë zyrtare të identifikimit, Librezën e Verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr.8098, date 28.3.1996 "*Për statusin e të verbërit*", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë, është vetëm Shërbimi Social Shtetëror⁴. Pra, Libreza e Verbërisë, e lëshuar nga autoritete të tjera, përfshi këtu Shoqatën “*Shpresë për të verbërit*”, nuk shërben si dokument provues për të përfituar sipas ligjit nr.8098, date 28.3.1996 "*Për statusin e të verbërit*", të ndryshuar.

Në lidhje me pretendimin e ankueses se është fyer dhe ofenduar gjatë udhëtimit nga ana e faktorinos z. E.Q , në bazë të provave të administruara nuk rezultoi i provuar. Pretendimi i palës ankuese në lidhje me shqetësimin e pretenduar se i ka ndodhur gjatë ushëtimit, nuk rezultoi i provuar. Gjatë

⁴ Vendim Nr. 53, datë 06.04.2023; Vendim Nr. 177, datë 04.06.2024; Vendim Nr.184, datë 24.06.2024, të Komisionerit.

shqyrtimit administrativ të çëhtjes nuk u arrit të administrohej asnjë fakt apo indicie në lidhje me këtë pretendim të ankueses.

Komisioneri thekson se, të gjithë udhëtarët duhet të marrin shërbimin në të njëjtat kushte e cilësi, dhe pa diskriminim pavarësisht nga aftësia e kufizuar. Në bazë të nenit 3, pika 13, të LMD, çdo sjellje e padëshiruar, kur lidhet me cilindo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, ku përfshihet edhe aftësia e kufizuar, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë, përbën diskriminim në formën e shqetësimit dhe është i ndaluar nga ligji.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 e 33, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

VENDOSI:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses znj. V.K për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Shoqërisë ELALBA - 1 sh.p.k.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Fusha: Shërbime/Transport
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim